



RAPORT

MBI PRIORITETET E QYTETARËVE TË MBLEDHURA PËRMES VOTIMIT ONLINE

NË BASHKINË DURRËS

2019

RAPORT

MBI PRIORITETET E QYTETARËVE TË MBLEDHURA PËRMES VOTIMIT ONLINE

NË BASHKINË DURRËS

2019

***E drejta e autorit ©Instituti AGENDA ©Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile (CSDC) Durrës 2019.
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Pjesë të këtij raporti mund të riprodhohen dhe/ose
përkthehen për qëllime jo-fitimprurëse me kusht që Instituti Agenda dhe CSDC Durrës të citohen
si burimi i materialit si dhe t'u jepen kopje të përkthimeve përkatëse.***

Të nderuar përfaqësues të pushtetit vendor,

Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile, CSDC Durrës në partneritet me Institutin AGENDA dhe mbështetur nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme, ka zbatuar një projekt që ka si qëllim kryesor rritjen e ndikimit direkt të qytetarëve në hartimin e buxhetit të bashkive me anë të një instrumenti efikas. Për rritjen e aksesit të qytetarëve në hartimin e buxhetit të bashkive është krijuar platforma **www.buxhetim.al** ku çdo qytetar mund të shprehë preferencat e tij për buxhetin e bashkisë. Në bashkinë Durrës platforma u shfrytëzua nga qytetarët gjatë periudhës 30 Tetor - 15 Dhjetor 2019. Të dhënat e mbledhura nga aplikacioni janë përpunuar dhe analizuar nga stafi dhe ekspertët e Institutit, duke nxjerrë edhe rezultatet mbi preferencat e qytetarëve që janë paraqitur më poshtë në këtë raport. Duke i shpërndarë këto të dhëna pranë drejtuesve të Bashkisë dhe Këshillit bashkiak Durrës, synohet informimi i autoriteteve mbi mendimet e shprehura nga qytetarët dhe mundësia që të merren parasysh në hartimin e buxhetit përfundimtar.

Të dhënat e mbledhura në Bashkinë Durrës

Nga bashkia Durrës 662 qytetarë janë përfshirë në plotësimin e formularit duke shprehur prioritetet e tyre mbi zërat e buxhetit, nga të cilët 224 janë *meshkuj* dhe 438 janë *femra*.




Figura 1.1 Gjinia e qytetarëve




Figura 1.2 Mosha e qytetarëve




Figura 1.3 Arsimimi i qytetarëve

- **Kategoritë e buxhetit**




Figura 1.4 Kategoritë e buxhetit

- **Nënkategoritë e buxhetit**

Zërat e buxhetit	Numri	Përqindja
Shëndeti publik	242	13%
Mbrojtja dhe siguria publike	196	10%
Ujësjetës kanalizime	110	6%
Investime në rrugë urbane, rurale, sheshe	102	5%
Sipërfaqe të gjelbërta	96	5%
Emergjenca civile	84	4%
Shërbimi i transportit	84	4%
Ndriçimi publik	82	4%
Bibliotekë	70	4%
Ndihma ekonomike	65	3%

- **Prioritetet sipas gjinisë**




Figura 1.5

- **Prioritetet sipas moshës**





Figura 1.6

• **Prioritetet sipas arsimimit**



• **Sugjerimet specifike të qytetarëve të Durrësit**

1. Qendra sociale të ketë më shumë. Më shumë parqe, pemë dhe lulishte.
2. Sa më shumë parqe dhe lulishte. Sa më shumë qendra pasi ato funksionojnë shumë mirë por ka shumë njerëz që kanë nevojë për to.
3. Mendoj që të gjithë njerëzit duhet të jenë të barabartë dhe të mbrojtur, duhet të investohet më shumë në këtë pjesë dhe të ketë barazi për të gjithë. Duhet të ketë banesa sociale por gjithashtu duhet të ketë lehtësi për çiftet e reja apo dhe për ndihmuar njerëzit të cilët nuk kanë banese fare. Të rikonstruktohen konviktet gjithashtu të mendohet të bëhen konvikte dhe mensa dhe për studentët e UAMD. Faleminderit po realizuat ndonjëherë prej tyre.
4. Të punohet më shumë për qytetin e Durrësit.
5. Shtimi i ambienteve të gjelbërta është shumë i rëndësishëm për qytetin tonë. Qendrat sociale janë shumë efektive, por janë shumë pak për numrin e popullsisë që kemi.

6. Biblioteka të hapura për të gjithë studentët. Ndërtimi i një konvikti. Prioritetet e kartës së studentëve
7. Në lagjet periferike të Durrësit veçanërisht lagja 15, rruga Varoshi i vjetër, bashkia duhet të investojë në mbylljen e kanaleve dhe rregullimin e rrugëve.
8. Shërbimi i transportit nuk është i mirë.
9. Prioritete që duhen mundësuar për qytetarët.
10. Rrugët janë pa ndriçim, sidomos në zonën ku jetoj unë në ish kënetën.
11. Probleme me kanalizimin dhe me linjën e urbanëve, hapja e konvikteve dhe menceve.
12. Rruga në Rashull është shumë e dëmtuar nuk ka rrugë me asfalt tek lagjia e Demave Rashull dhe gjatë kohës së shiut na mbyti balta.
13. Rrugica Rezistenca nuk është përfunduar dhe punimet janë ndërprerë dhe janë lënë përgjysëm. Ju lutemi vazhdoni punimet në shërbim të komunitetit
14. Ne jemi studentë dhe orari i autobuzëve për në universitetin e Spitallës nuk përputhet me oraret e mësimëve tona. Duhet të ketë konvikte për universitetet për studentët të cilët janë larg univesitetit.
15. Infrastruktura në rrugën Xhafzotaj dhe ndriçimi në këtë zonë.
16. Menaxhimi i koshave nëpër rrugë. Ndërtimi i banesave sociale në shërbim të individit. Mirëmbajtja e bibliotekave si rregulli parësor.
17. I gjithë qytetit përmbytet sa herë që bie shi. Menaxhimi i koshave të mbeturinave. Rikonstrurimi i shkollës së mesme "Naim Frashëri". Krijimi i konvikteve për arsimin universitar. Të ketë më shumë organizime nga bashkia.
18. Jetoj në lagjen 15, rruga "Isuf Recit" dhe rruga është e pashtuar.
19. Infrastuktura në rrugën e vjetër Tirane-Durrës. Pjesa nga Rrashulli deri në Sukth.
20. Pastrimi i koshave të mbeturinave të paktën një herë në dy ditë.
21. Ujësjellës dhe kanalizime. Arsyja e kësaj zgjedhje është ndikuar nga ngjarja aktuale e disa ditëve më parë ku qyteti i Durrësit u përmbyt nga shirat e bollshëm e kjo solli probleme në transport e në fusha të tjera. Shërbimi i pastrimit, mungese e theksuar e shërbimi ta pastrimit cilësor ku mungon ndarja e mbeturinave, kapakët e koshave mungojnë, koshat nëpër lagje.
22. Aksi rrugor Tiranë-Ndroq-Plepa është në gjendje shumë të keqe. Problemi qëndron tek gropat e shumta, shtrimi i rrugës, sinjalistika e saj dhe mirëmbajtja në përgjithësi. Është e pamundur të udhëtosh!
23. Duke u fokusuar tek rinia dhe duke i dhënë asaj mundësi që të zgjerojnë aktivitetet e tyre. Gjithashtu një ambient i gjelbërt krijon një shoqëri më sociale, aktive dhe përhap pozitivet tek njerëzit pavarësisht moshës.
24. Të sigurohet përmirësimi i kushteve të markatës sepse është vendi ku ne blejmë ushqimet që hamë.
25. Përmbytjet, gjelbërimi kudo në qytet, qendra sportive.
26. Buxheti duhet të parashikojë minimumi 4% për emergjenca civile. Kanalizimet janë shumë problematike, me këtë shiun e parë u përmbyt pjesa e trenit.
27. Mendoj që është e rëndësishme që të investohet në arsim pasi është baza e një shoqërie. Duhet të bëhen pyetësorë të ndryshëm drejtuar nxënësve, prindërve dhe

- mesueseve për të kuptuar më mirë gjendjen në të cilën ndodhen shkollat tani dhe për tu përpjekur për ta përmirësuar për brezin e ardhshëm dhe atë që është tani.
28. Mos shtrohet asfalti edhe të çahet sërish për të shtruar tubat e ujit.
 29. Kam zgjedh këto 3 prioritete pasi në bashkinë e Durrësit ka shumë të pastrehë. Kjo është çështje e rëndësishme për mua pasi nuk mendoj se kjo është e drejtë. Në çdo cep të Durrësit shoh njerëz të pastrehuar. Në rrugët e Durrësit ndriçimi mungon në disa lagje. Për shembull tek lagjia 17, në çdo rrugicë ndriçimi mungon. Dhe urbanet e universitetit në raste shiu nuk ndalojnë sepse uji është me shumicë, 2 stacione që unë di janë përballë tregut industrial dhe te rreth rrotullit. Shpresoj që të meren për bazë.
 30. Duhet bërë politika dhe kontrata me shoqatat private dhe publike që ofrojnë shërbime të sigurise dhe kontrollit kryesisht në shkolla dhe çerdhe, gjithashtu në stacione urbanesh. Si dhe marrjen e masave për personat që kanë pasur precedent penal në lidhje me vjedhje etj.
 31. Të pastrohen varrezat publike të paktën çdo 2-3 javë.
 32. Në zonën e bashkisë Durrës shumë të pastrehë flenë rrugëve.
 33. Në lagjen Faria Durrës mungon sistemi i ndriçimit të rrugëve natën. Ju lutem merreni parasysh këtë kërkesë. Faleminderit.
 34. Jam banore e zones "Durrësi I Ri" dhe në këtë zone ka mungesë të theksuar të sipërfaqeve të gjelberta, si dhe të organizimeve të aktiviteteve kulturore rinore dhe sportive. Do të isha shumë e kënaqur në qoftë se ju do ta merrnit në konsideratë këtë problem për banorët e kësaj zone. Faleminderit!
 35. Shpresojmë që Durrësi të jetë një shembull konkret i buxhetimit me pjesëmarrje. Pune të mbarë!
 36. Përshendetje! Sygjerimi im për bashkinë e Durrësit është: Shtimi i punonjësve social për të fituar nga eksperiencat e disa individëve për rregullimin e disa politikave dhe marrë zgjidhjen e disa problemeve që bejen të mundur zhvillimin e shoqërisë së një qyteti ose komuniteti.
 37. Rruga Fatmir Haxhihyseni, Lagjia 14 Shkozet, Kompleksi i pallateve të Bashkisë Durrës pranë Aiba, kërkohet skarifikim i rrugës, shtresë stabilizanti dhe asfalt. Rruga bashkë me 2 anekse përbëhet nga 860m².
 38. Komunikimi dhe ndërgjegjësimi më i lartë shëndetësor. Futja e më shumë projekteve në konkurse dhe aktivitete. Fusha sportive dhe palestra. Zhvillimi i një biblioteke moderne dhe të pasur me libra.
 39. Të ketë më shumë buxhet për shëndetin publik për shkak të ekonomisë. Banesa sociale për njerëzit pa shtëpi.
 40. Mungesa e dritave në rrugën Bruksel, Nishtulla. Vonesat e autobusave dhe mungesa e profesionalitetit të fatorinove dhe shoferëve në autobusa. Vonesat e urbaneve të linjës Rrashbull-Nishtulla-Durrës. Urbanët në fundjavë vetëm një në orë vijnë në linjën Universiteti A. Moisiu- Durrës.
 41. Rruga "Traktati i Natos" nuk është e shtruar, i mungon ndriçimi dhe kanalizimet e duhura. Në Durrës në kohën me shi ka përmytje për shkak të kanalizimeve.

42. Problemi më i madh është që në fshatin Qerret të qytetit durrës nuk ka urban për të lëvizur nga fshati në qytet.
43. 1- Të bëhet një projekt afatgjat dhe një studim i mirë në lidhje me investimet dhe punimet e kanalizimeve, diçka e menduar mirë që mos ti rriktheheni një rrugë mbas 2 muajsh ta rihapni përsëri.
2- Shikoj të domosdoshme investim tek ekipet sportive të qytetit tim si ambjeteve e palestrave, apo projekteve gjithpërfshirëse e femijeve dhe nxënësve nëpër shkollat 9 vjeçare apo të mesme në edukimin fizik, mund të hartojmë apo demostrojme nëpër ambjete një orë disiplina të ndryshme.
44. Organizim i emergjencave civile kurdo ndodhin katastrofa natyrore. Emergjencat civile në Shtator e Nëntor treguan mungesë shpejtësie e përgjegjshmërie.



**Përmirësimi i Procesit të
Buxhetimit të Konsultuar
dhe me Pjesëmarrje**

**Improvement of Consulted and
Participatory Budgeting Process**